



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Sasha Millosheviq, Kryetar i Komunës së Novobërdës Milica Jovanovic, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Novobërdës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së	
Nga:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL-së Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL	Datë: 10.06.2025 VI-020-345
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Novobërdës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Novobërdës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr. 01-514 mbi dhënien në shfrytëzim afatgjatë të patundshmërisë Komunale me negociim të Kryetarit të Komunës
I miratuar më datë: 30.05.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.06.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Novobërdës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.05.2025, ka miratuar, vendimi Nr. 01-514 mbi dhënien në shfrytëzim afatgjatë të patundshmërisë Komunale me negocim të Kryetarit të Komunës.

MAPL, konstaton se akti i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Novobërdës, është i bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d, dhe nenin 14, paragrafi 1, të Ligjit, Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në baze të nenin 6, paragrafi 1, dhe pika 1.2 nenin 8, paragrafi 1, pika 1.3, e Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 23, paragrafi 2 dhe 4, pika 4.1 dhe paragrafi 6, pika 6.3, të Rregullores Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim zhvillimin ekonomik përkatësisht investimi në sektorin e prodhimitarisë dhe punësimi në Komunën e Novobërdës.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e rregullt të kuvendit të Komunës së Novobërdës me datë 30.05.2025, me 10 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim.

Neni 23, i Ligji Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, përcakton se :

1. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Saša Milošević, gradonačelnik opštine Novo Brdo Milica Jovanović, predsedavajuća Skupštine opštine Novo Brdo
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,
Od:	Erbilin Hetemi, direktor Pravnog odeljenja/ MALS Datuma, 10.06.2025 VI-020-345
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika Donjeta Cakolli, viša službenica za razmatranje zakonitosti opštinskih akata
1.Službenik za potvrđivanje pravne procene:	
2.Službenik za izradu pravne procene	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Novo Brdo
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine Novo Brdo

Poštovani/a gradonačelnice,

Poštovani/a predsedavajući,

U saglasnosti sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 01-514 o davanju na dugoročno korišćenje opštinskih nepokretnosti putem pregovora sa gradonačelnikom opštine

Usvojena dana, 30.05.2025.godine,

Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 02.06.2025. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Novo Brdo je na sednici održanoj dana, 30.05.2025.godine, usvojila Odluku br.01-514 o davanju na dugoročno korišćenje opštinskih nepokretnosti putem pregovora sa gradonačelnikom opštine.

MAIS konstatuje da je usvojeni akt od strane Skupštine opštine Novo Brdo, zasnovan na članu 12 stav 2 slovo d, i član 14 stav 1 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, kao i na osnovu člana 6 stav 1 i tačke 1.2 člana 8 stav 1 tačka 1.3 Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, član 23 stav 2 i 4 tačka 4.1 i stav 6 tačka 6.3 Uredbe br. 09/2020 o utvrđivanju postupka davanja na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, u cilju ekonomskog razvoja, odnosno ulaganja u proizvodni sektor i zapošljavanja u opštini Novo Brdo.

Odluka je usvojena na redovnoj sednici Skupštine opštine Novo Brdo dana, 30.05.2025.godine, sa 10 glasova za, 1 protiv i 1 uzdržan glas.

Član 23. Zakona br. 06/L-092 o o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, utvrđuje da:

1. Nakon isteka roka određenog ugovorom o davanju na korišćenje nepokretne imovine opštine, imovina se vraća opštini.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.